

PËRMBLEDHËSE (nga data 11 deri 17)

PARASHIKIMI METEO :

RESHJET

Sot pasdite (dt.11) priten reshje në të gjithë territorin, që do të vazhdojnë (me ndërprerje) edhe gjatë ditës së nesërme (dt.12), kryesisht PARADITE. Në ZONA TË KUFIZUARA shirat do të jenë INTENSIVË në formë SHTRËNGATE, me RRUFE, breshër (me dimensione të mëdha) dhe ERË MOMENTALE TË FORTË. **Intensiteti i lartë i reshjeve mund të krijojë probleme të kufizuara në rrjetin e kanalizimeve në zonat urbane.**

Pasnesër (dt.13): që në orët e para të mëngjesit priten reshje lokale, kryesisht në Veri të vendit. Pasdite pritet një pakësim i mundësisë për reshje.

Në ditët e tjera të kësaj periudhe NUK priten reshje, përjashtuar raste shumë të izoluara, më të mundshme në TERRENET KODRINORE-MALORE gjatë pasditeve; në përgjithësi, të dobëta.

ERA

Sot pasdite (dt.11) dhe nesër (dt.12) era do të jetë problematike, sepse do të forcohet, veçanërisht në bregdet dhe në terrenet malore (për momente, **mbi 50 km/orë**).

Në ditët e tjera do të ketë forcime të përkohshme të erës, zakonisht në ORËT E PASDITES, sidomos në bregdet dhe në terrenet e larta malore, ku mund t'i kalojë 30km/orë.

ZJARRET

Sot pasdite (dt.11): niveli i rrezikut do të pësojë një rritje në të gjithë territorin, më e theksuar në pjesën Qendrore dhe Jug-Lindore (siç tregohet në tabelë dhe hartë, respektivisht në faqet 2 dhe 3).

Nesër (dt.12): shumica e qarqeve do të jenë në nivelin "S'KA RREZIK".

Pasnesër (dt.13) deri në dt.17: pritet një rritje graduale e rrezikut në të gjithë qarqet, më pak e ndjeshme në zonën V-P.

NIVELET E RREZIKUT

S'KA RREZIK

I ULËT





















MESATAR

I LARTË



Instituti i Gjeoshkencave, Energjisë, Ujit dhe Mjedisit – IGJEUM

PARASHIKIMI I DETAJUAR MBI RREZIQET NATYRORE (SOT DHE NESËR)

RREZIKU MAKSIMAL I QARKUT	Ngjarje Klimatologjike	Ngjarje Meteorologjike				Ngjarje Hidrologjike		
	Zjarre në Pyje Mesatarja e qarkut	Reshje 24-orëshe Mesatarja e qarkut	Reshje 24-orëshe Maksimale të lokalizuara	Rrufe	Shtrëngata	Përmbytje të Shpejta	Përmbytje Lumenjsh	Rrëshqitje toke
Shkodër	S'KA RREZIK	intensive	sh. intensive					
Kukës	MESATAR	mesatare	intensive					
Dibër	MESATAR	të dobëta	mesatare					
Lezhë	I ULËT	intensive	sh. intensive					
Durrës	I ULËT	mesatare						
Tiranë	MESATAR	të dobëta	mesatare					
Elbasan	MESATAR	të dobëta	mesatare					
Fier	MESATAR	të dobëta	mesatare					
Berat	MESATAR	të dobëta	mesatare					
Korçë	MESATAR	të dobëta	mesatare					
Vlorë	MESATAR	të dobëta	mesatare					
Gjirokastrë	MESATAR	të dobëta	mesatare					




Instituti i Gjeoshkencave, Energjisë, Ujit dhe Mjedisit – IGJEUM

LEGJENDA Reshjet 24-orëshe

Niveli i Rrezikut	Reshje shiu (mm / 24 orë)
S'KA RREZIK	të dobëta (0 – 15)
I ULËT	mesatare (15 – 45)
MESATAR	intensive (45 – 90)
I LARTË	shumë intensive (> 90)

LEGJENDA Zjarret

S'KA RREZIK	Zjarret e mundshëm janë të kontrollueshëm lehtësisht nga skuadrat e zjarrfikësve.
I ULËT	Nuk rekomandohen zjarret e kontrolluara, sepse bëhen vatra për ndezjen e zjarreve. Barërat e thatë dhe pyjet mund të digjen lehtë. Flakët janë te mesme në pyje dhe të shpejta në zonat e ekspozuara. Duhet të përdorim të gjitha mjetet për shuarjen e flakëve të zjarreve.
MESATAR	Ndezje mund të ndodhin lehtë me një përhapje të shpejtë në shkurre, barë dhe pyje. Zjarret mund të jenë shumë të nxehtë, me kurora përhapje të vogla dhe të mesme. Ndërhyrja direkte në kokën e zjarrit mund të jetë e pamundur, kërkohet ndihma e metodave dhe mjeteve të tjera plotësuese.
I LARTË	Ndezja mund të vijë edhe nga një shkëndijë. Zjarret janë jashtëzakonisht të nxehtë me një përhapje shumë të shpejtë të flakëve. Kontrolli i tyre nuk mund të jetë i mundur gjatë ditës për shkak të rrezes së gjatë të përhapjes dhe të kurorës. Forcat e shuarjes duhet të përqendrojnë përpjekjet për të kufizuar përhapjen laterale të zjarrit. Dëmtim total i zonës.



	Shtrëngata: reshje mbi 20 mm/3orë, moti mund të krijojë probleme të ndryshme
	Përmbytje urbane ose nga përrrenjtë dhe lumenjtë e vegjël
	Përmbytje nga lumenjtë e mesëm dhe të mëdhenj
	Rrëshqitje toke
	Mundësi për rrufe

